



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 4431 Prot

Peshkopi, më 22.09.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.72

Data: 16.09.2022

“ Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2022, familjeve në nevojë që janë përjashtuar nga sistemi për arsye të pikëzimit, duke përdorur fondin e kushhtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, I ndryshuar.” ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Miki





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR



Nr.918/1 prot

Peshkopi më 26.09.2022

Lënda: Për vendimin Nr.72, datë 16.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

Drejtuar: Bashkisë Dibër.

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, si dhe në bazë të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacioni dhe masës së përfutimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6%” pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.72, datë 16.09.2022 “*Per dhenien e ndihmës ekonomike për muajin korrik 2022 familjeve në nevojë që janë përyshuar nga sistemi për arsye të pikëzimit ,duke përdorur fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, i ndryshuar*”, vendosa miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi që është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e administratës së bashkisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 72 Datë 16/09/2022

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN KORRIK 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfinitit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **16.09.2022** miratoi me 18 vota pro 0 kundër 0 apstenim 6% e muajit Korrik 2022.

VENDIMI:

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2022 **463** familjeve në nevojë me fond **2.158.974** të cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese.
2. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kriterëve të përcaktuara me ligji.
3. I bashkangjitet këtij vendimi lista emërore me shumën përkatesë sipas Njësive Administrative.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi u shpall sot më datë 16.09.2022

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

